

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me 01.08.2024, midis paleve;

GRUPPO DENIM FACTORY, zoterues i nje kuote te barabarte me 100% te kapitalit themeltar, ekuivalente me 100.000 lek, ne shoqerine KEJSI XHINS shpk, shoqeri shqiptare e themeluar me 25.10.2011 dhe regjistruar ne QKB me NIPT L12301029B, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, (SHITESI).

DHE

Fayek Ahmed, i datelindjes 01.02.1993, ne Sylhet, Bangladesh, me banim ne Palma Campania, Itali, i identifikuar ID AY7859961, e vlefshme deri me 01.02.2028, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, (BLERESI).

Personat e lartpermendur deshirojne dhe jane te gatshem per te lidhur kete Kontrate sipas kushteve te meposhtme:

Neni 1 Shitja E Kuotave

Nepermjet kesaj kontrate:

GRUPPO DENIM FACTORY, zoterues i nje kuote te barabarte me 100 % te kapitalit te shoqerise me vlere nominale 100.000 leke, i shet, **Fayek Ahmed**, nje kuote te barabarte me 100% te kapitalit te shoqerise me vlere nominale 100.000 leke.

Pas shitjes te kuotes, **Fayek Ahmed** behet zoterues i nje kuote te barabarte me 100% te kapitalit themeltar te shoqerise me vlere nominale 100.000 lek

Neni 2 Cmimi i shitjes

Cmimi i shitjes se kuotes eshte vendosur vlere nominale e kuotes prej 100% ne zoterim te **GRUPPO DENIM FACTORY** me vlere 100.000 lek

Kalimi i pronesise se kuotave do te kryhet me nenshkrimin e kesaj kontrate.

Neni 3 Deklarime dhe garanci te paleve 3.1. Deklarime dhe garanci te shitesit

Duke konsideruar kete kontrate shitjesh kuotash dhe kushtet e Shoqerise, shitesit dhe bleresit ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate, japin deklarimet dhe garancite si vijon (me poshte "Deklarimet dhe Garancite e shitesit"):

- Shoqeria eshte themeluar dhe operon rregullisht ne baze te ligjit dhe te drejtes tregetare shqiptare si dhe ne baze te gjithe legjislacionit dhe akteve te shoqerise, ka te drejta te plota per te vepruar mbi pronesine e shoqerise konform dhe statutit te shoqerise.
- Shoqeria nuk ka debi apo kredi te cfaredolloj tipi, qe nuk jane te perfshira ne regjistrat kontabel te shoqerise deri ne afatin e nenshkrimit te kesaj kontrate.

- Shoqeria nuk eshte pjese e asnje ceshtje konfliktuale aktuale apo te kaluar apo pale e lidhur ne ndonje konflikt ligjor, qofte edhe e denoncuar ne gjykate kombetare apo nderkombetare apo organ administrativ apo kolegji arbitrazhi edhe nepermjet kontroleve dhe procedimeve qe kane per objekt pergjegjesine administrative.
- Shoqeria nuk ka dhunuar asnje normative ligjore dhe ka vepruar ne respekt te normativave te aplikueshme per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise.
- Persa ne dijeni te Shitesit, nuk konsiderohet false apo e pasakte asnje deklarim apo e drejte garancie e dhene ne kete kontrate.

3.2. Deklarime dhe Garanci te Bleresit

Per sa lidhur ne kete kontrate shitjesh kuotash, Bleresit japin deklaratat dhe garancite si vijon:
(Ne vijim, deklarimet dhe Garancite e Bleresve):

- Bleresit deklarojne se jane informuar dhe kane dijeni mbi dokumentacionin fiskal dhe kontabel te shoqerise si dhe mbi te gjitha kartelat e detajuara pjese perberese e bilancit deri me sot.
- Bleresit deklarojne se kane dijeni te plote mbi situaten e shoqerise edhe ne marredhenie me bankat, pagat, entet shtetore, furnitoret dhe kreditoret dhe pranon situaten aktuale si paraqitet deri me sot.

3.3. Adminstrimi i shoqerise

Administrator i vetem i shoqerise dhe perfaqesues ligjor, do te jete **Fayek Ahmed**, i datelindjes 01.02.1993, ne Sylhet, Bangladesh, shtetas Bangladeshas, banues ne Palma Campania, Itali, mbajtës i ID AY7859961.

Neni 4 Shpenzime dhe Taksa

Shpenzimet ligjore dhe kontabile, taksat dhe te tjera te lidhura me kete kontrate, jane ne ngarkim te pranesit te Bleresit

Neni 5 Klauzola kalimtare dhe zgjidhja e kontrates dhe mosmarreshjeve

Per te gjitha mosmarreshjet qe rrjedhin nga zbatueshmeria e kesaj kontrate pas nenshkrimit te saj, perfshire ato te lidhura me vlefshmerine e saj, interpretimit dhe zbatimin e rregullores; palet do te kerkojne zgjidhje prane Gjykates se Tiranes, Shqiperi.

Neni 6 Ndryshimi i Kontrates

Kjo kontrate perfshin raportin midis paleve dhe krijon marredhenien midis te gjithe aktoreve te lidhur ne kete kontrate persa i perket objektit te saj. Ndryshimet apo shtesa ne kete kontrate do te quhen te vlefshme vetem ne forme te shkruar dhe nenshkruar midis paleve.
Kjo kontrate u hartua ne 3 kopje me te njejten vlere ligjore dhe perbehet nga 3 flete.

SHITESI

GRUPPO DENIM FACTORY

[Signature]



BLERESI

FAYEK AHMED

[Signature]